



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:036080

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638018

P.nr. 12/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË NOVOBËRDËS, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me Bashkëpunëtorin profesional Zvezdan Milenković, në lëndën penale kundër të pandehurit H. M. nga fsh. Tullar, Komuna Novobërdës, për shkak të veprës penale: vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-ës, në Gjilan, PP.II.nr.49/2024, të datës 26.01.2024, duke vendosur sipas kërkesës së PTH-së në Gjilan, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor, më datë 30.04.2024, hartoi dhe publikoi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-ës nga Gjilani PP.II.nr. 49/2024, të datës 26.01.2024, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit,

H. M., nga babai Imer, i lindur më dt.20.04.1983, në fshatin Kllobukar, Komuna Novobërdës, me vendbanimin në fshatin Tullar, komuna e Novobërdës, me nr. personal 1000013885, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r

Më datë 23.05.2023, rreth orës 18:00, në fsh. Qulkovc, Komuna e Novobërdës, në vendin e quajtur “Sumaci”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të vjedhjes i ka prerë (30) tridhjetë copa trungje lisi, me diametër në cung 18-20cm, me lartësi të drurit 18cm, prej 10m, me vëllim fizik të përgjithshëm 3.57m³, të cilat i ka prerë me motor sharrë elektrike, të cilat i kishte të ngarkuara në traktor IMT 540, në këtë mënyrë me këto veprime i ka shkaktuar dëm material palës së dëmtuar Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Novobërdë në shumën të pa përcaktuar.

- Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-ës, si dhe nenit 364 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurin H. M. e,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilën gjobë i pandehuri ka për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, nëse i pandehuri nuk e arkëton dënimin me gjobë në afatin prej 15 ditëve, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që çdo ditë burgu do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Pala e dëmtuar APK në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor ta arkëtoj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjithashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan – Departamenti për krime të përgjithshme, më datën 31.04.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.49/2024, kundër të pandehurit H. M., nga fshati Tullar, Komuna Novbërdës, për shkak të veprës penale: vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1, të KPRK-së, ndaj të cilit ka paraqitur edhe kërkesën për dhënien e Urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit të i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 493 parag. 2, lidhur me parag.1 të KPPRK-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi aktakuzën, Kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës dhe konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në aktin e akuzës siç janë: Fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit dhe vlerësimi i dëmit, nr.19/23, i dt.23.05.2023, deklarata mbi marrjen në pyetje të të pandehurit Hasan Mustafa, më dt. 25.01.2024, raporti i policisë i dt.25.01.2024, shënimi zyrtar i dt. 23.05.2024, si dhe shkresat tjera në lëndë, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikojë tek të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, prandaj e aprovoi kërkesën e PTH-së nga Gjilani, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të pandehurit i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë.

Pala e dëmtuar APK në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, e në pajtim me dispozitat e nenit 452 lidhur me nenin 449, paragrafi 2, pika 2.6 e KPPRK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro) si dhe shumën prej 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat e më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:036080, 30.04.2024

G j y q t a r i ,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhrin ndëshkimor mundë të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i paraqitet kësaj gjykate, e pastaj gjykata do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor në pajtim me nenin 496 parag. 4 i KPPRK-së.